

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtari Ibrahim. Idrizi kryetar i trupit gjykues, dhe gjyqtarëve profesional Sahit Krasniqi e Elmaz Zenuni, anëtarë të trupit gjykues, me sekretaren juridike Qëndresa Bobi, në çështjen penale kundër të akuzuarve: E.N.1, Sh.N, M. N, B.N, H. N e E.N.2 për shkak të veprës penale vrasja e rëndë nga neni 147 par. 1 nën par. 9 në bashkëkryerje lidhur me nenin 23, të veprës penale vrasja e rëndë në tentative nga neni 147 par. 1 nën par. 9 në bashkëkryerje lidhur me nenin 20 e 23 si dhe të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK-së, të akuzuar sipas aktakuzave të Prokurorisë Publike të Qarkut në Prishtinë PP.nr 111-2/10 të datës 29.12.2010, PP.nr 11-7/10 të datës 10.10.2011 dhe PP.nr 111-2/10 të datës 18.09.2012, pas shqyrtimeve gjyqësore të mbajtura me 15, 16, 17.04.2013, 13, 14, 29.05.2013, 01.07.2013, 12.09.2013, 01.10.2013 dhe me 3 tetor 2013 në prani të Prokurorit të shtetit Florije Salihu Shamolli, të akuzuarve E.N.1, Sh.N, M. N, B.N, H. N e E.N.2 dhe mbrojtësve të tyre avokateve Fazli Balaj, Aziz Rexha, Bahtir Troshupa, Shemsedin Piraj e Muhamet Beqiri, shpall dhe publikisht komunikoi këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

1.E.N.1, i biri i dhe nënës, e gjinisë, i lindur me, në fsh. Burnnik, K. Ferizaj, tani me banim në fsh. Gaçkë, K. Ferizaj, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, prind i katër fëmijëve, gjendet në paraburgim prej datës 19.02.2010.

2.SH.N, i biri idhe nënës, e gjinisë, i lindur me, me vendbanim në fshatin Bajnicë, K. Ferizaj, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, prind i nëntë fëmijëve, gjendet në paraburgim prej datës 18.02.2010.

3.M. N, i biri i dhe nënës, e gjinisë, i lindur me, me vendbanim në fshatin Burnnik, K. Ferizaj, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, në paraburgim gjendet prej datës 18.02.2010.

4.B.N i, i biri i dhe nënës, e gjinisë i lindur me, me banim në fshatin Burnnik, K.Ferizaj, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, në paraburgim gjendet prej 18.02.2010.

5.H. N, i biri i dhe nënës, e gjinisë, i lindur më, në fshatin Burrnik, K. Ferizaj, ku edhe banon, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, bujk, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së varfër ekonomike, gjendet në paraburgim , prej datës 02.08.2011.

6.E.N.2, i biri i dhe nënës, e vajzërisë, i lindur më, me banim në fshatin Gaçkë, Komuna Ferizaj, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, bujk, i martuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, mbrohet në liri.

Janë fajtor

I.

I akuzuari **E.N.1.**,

1-a, se me datë 18.02.2010, rreth orës 17.30, në afërsi të mobilierisë “.....”, në fsh.Greme, Komuna Ferizaj, me dashje direkte nga hakmarrja e paskrupullt, e ka privuar nga jeta tani të ndjerin B.V nga fshati Greme , Komuna Ferizaj për shkak te mosmarrëveshjeve dhe rrahjeve te mëhershme rreth një mali kontestues ne fsh. Burrnik, Komuna Ferizajt, e që për këtë çështje me datë 17.02.2010, ne Ferizaj, të dëmtuarit V e F.V ishin rrahur me B.N – djali i vëllait të të akuzuarit E.N.1, që i kishin shkaktuar lëndime në kokë, në atë mënyrë që deri sa i ndjeri B.V së bashku me djemtë e tij V. e F, me automjetin e tyre të markës “.....”, ishin duke u kthyer për ne shtëpinë e tyre në fshatin Greme, i akuzuari E.N.1. bashkë me të akuzuarin M., me veturën e tij të markës “.....”, ishin duke shkuar në drejtim të Ferizajt, posa vëren automjetin e tani të ndjerit B., e kthen veturën e tij në drejtim të fshatit Greme, duke lëvizur pas veturës së të ndjerit, që para mobilierisë “” e tejkalon, pastaj ia bllokon rrugën me veturën e tij dhe prej kësaj veture dalin të akuzuarit E.N.1. e M. N, të armatosur me armë zjarri, dhe atë E.N.1 i me revole të markës TT, kurse M. me pushkë automatike. Në ndërkohë aty vijnë edhe të akuzuarit H.N e E.N.2, fillon rrahja në mes të M. ku marrin pjesë edhe H. e E.N.2 dhe të dëmtuarve V. e F. V., ndërkaq i akuzuari E.N.1. nga një distancë prej 2-3 metra, shtënë dy herë me revole të tipit TT në drejtim të B.V të cilin me një predhë e qëllon në pjesën e jashtme në krahun e majtë nën bërryl, ndërkaq me një predhë e qëllon në pjesën e jashtme të krahut të majtë mbi bërryl, e cila predhë depërton në pjesën anësore të majtë të kafazit të kraharorit, dhe si pasojë e dëmtimit të organeve në zgavrën e kraharorit,mushkërisë ,enës kryesore të gjakut-aortën dhe gjakderdhjes së shpejtë të brendshme të shkaktuar nga veprimi dinamik i predhës, i ndjeri B.V vdes në vendin e ngjarjes,

me këtë kreu veprën penale vrasja e rëndë nga neni 147 par. 1 nen par. 9 të KPK-së.

1-b. Që nga periudha kohore e pa vërtetuar deri me datë 18.02.2010, rreth orës 17.30 , si në të gjitha rrethanat e përshkruara si në pikën **I -1** te dispozitivit, pa leje valide dhe pa autorizim, ka mbajtur një revole të tipit “ Cervena Zastava” e modelit M-57 te kalibrit 7.62x25 mm, me nr. serik,1 karikator për këtë revole , si dhe 14 fishekë te kalibrit 7.62x25mm, të cilën armë e ka përdorur për kryerjen e veprës penale vrasja e rende, dhe e cila është sekuestruar nga policia,

me këtë kreu veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll , posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK-së.

I akuzuari **M. N,**

2-a, se me datë , kohë dhe vendin e cekur si në dispozitivin **1** të këtij aktgjykim, me dashje direkte , nga hakmarrja e paskrupullt ka tentuar që ti privoj nga jeta të dëmtuarit V. e F. V., në atë mënyrë qe pasi ka zbritur nga vetura e markës ”, fillon rrahja në mes tij dhe të dëmtuarve V. e F. V., që gjatë rrahjes i akuzuari M.N përdor një dru, e pastaj nga vetura e merr pushkën automatike AK-47 kal.7.65 mm, me numër serik, dhe shtënë në drejtim të të dëmtuarve V. e F. V., me ç’rast me një predhë e qëllon të dëmtuarin V. në kofshën e këmbës së djathtë, duke i shkaktuar kështu lëndime të lehta trupore,

me këtë ka kryer veprën penale vrasja e rëndë në tentativë nga neni 147 par 1 nen par 9 të KPK-së.

2-b.Nga periudha kohore e pa vërtetuar deri me 18.02.2010, rreth orës 17.30, pa leje valide dhe pa autorizim ka mbajtur armën – pushkën automatike te tipit AK-47 e modelit kinez type – 56 , kalibrit 7.62x39 mm, me numër serik, një karikator për këtë pushke automatike, me të cilën ka shtënë në drejtim të dëmtuarve V. e F. V. të përshkruar si në pikën **I-3**, të dispozitivit dhe e cila armë sekuestrohet nga policia,

me këtë ka kryer veprën penale mbajta në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar te armeve nga neni 328 par. 2 te KPK-se.

Te akuzuarit **H.N e E.N.2,**

3. se me datë 18.02.2010,rreth orës 17.30 në rrugën Ferizaj – Greme afër mobilierisë “.....”, kanë marr pjese në rrahje e cila ka rezultuar me vdekjen e një personi , që fillimisht rrahja ka filluar në mes të të akuzuarit M. N në një rënë anë dhe të dëmtuarve V. e F. V. në anën tjetër, e që të akuzuarit H.N dhe E.N.2 duke marr pjesë në këtë rrahje me veprimet e tyre dhe në atë mënyrë që i kanë thënë te akuzuarit M.N “ *vraje qenin*”, duke aluduar në të dëmtuarin V. dhe duke u vërsulur në drejtim të të dëmtuarit V., deri sa i njëjti i qëlluar në këmbë nga predha e pushkës automatike të shkrepur nga i akuzuari M.N, rrëzohet ne kanalën e rrugës,

me këtë kanë kryer veprën penale pjesëmarrje në rrahje nga neni 155 par 1 të KPK-se.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të neneve 3,6,11,15,20, 34, 38,64,65 par 2, 71, 147 par 1 nen par 9, 328 par 2 te KPK-së, si dhe nenit 391 të KPPK-së, përcakton dhe atë:

Te akuzuarit E.N.1.:

Për veprën penale vrasja e rëndë nga neni 147 par. 1 nën par. 9 të KPK-së, të përshkruar si në piken **I/1-a**, te dispozitivit, dënim burgimi në kohëzgjatje prej 18 (tetëmbëdhjetë) vite.

Për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armeve nga neni 328 par. 2 të KPK-së, të përshkruar si në piken **I/1-b**, dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite.

Te akuzuarit M. N:

Për veprën penale vrasja e rëndë në tentative nga neni 147 par. 1 nën par. 9 të KPK-së, të përshkruar si në piken **I/2-a**, dënim burgimi në kohëzgjatje prej 10(dhjetë) vite.

Për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK-së, të përshkruar si piken **I/2-b**, dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 (dy)vite.

Ashtu që gjykata në bazë të nenit 71 par 1 të KPK-së, si dhe të dispozitave të cekura ligjore,

I g j y k o n

Të akuzuarin E.N.1.,

Me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 19 (nëntëmbëdhjetë) vite.

Në dënimin e shqiptuar do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim dhe atë prej datës 19.02.2010, deri sa aktgjykimi të merr formën e prerë por jo më shumë se koha e dënimit të caktuar me aktgjykim PKR 6/2013 të datës 3 tetor 2013.

Të akuzuarin M. N

Me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 11 (njëmbëdhjetë) vite.

Në dënimin e shqiptuar do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim dhe atë prej datës 18.02.2010, deri sa aktgjykimi të merr formën e prerë por jo më shumë se koha e dënimit të caktuar me aktgjykim PKR 6/2013 të datës 3 tetor 2013.

Të akuzuarin : H. N

Dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1(një) viti.

Në dënimin e shqiptuar do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim dhe atë prej datës 02.08.2011.

Të akuzuarin: E.N.2

Dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1(një) viti.

Dënimin e shqiptuar do ta vuaj pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

Konfiskohen në mënyrë te përhershme arma – pushka automatike të tipit AK-47 e modelit kinez type – 56 , kalibrit 7.62 mmx39 mm, me numër serik, një karikator për këtë pushke automatike, dhe një revole të tipit “ Cervena Zastava” e modelit M-57 të kalibrit 7.62x25 mm, me nr. serik,1 karikator për këtë revole , si dhe 14 fishekë të kalibrit 7.62x25mm.

Obligohen të akuzuarit që ti paguajnë gjykatës shpenzimet e procedurës penale në shumë prej nga 20.44 euro secili, si dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej nga 100 euro secili, dhe atë në afat prej 30 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

Të dëmtuarit M, V. e F. V. nga fshati Greme, K. Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

II.

Konformë nenit 389 par 1 nën par 1 te KPPK-se, ndaj të akuzuarve:

Sh.N dhe B.N,

REFUZOHET AKUZA

1-a.Se me datë 18.02.2010, rreth orës 17.30 min, në afërsi të mobilerisë “.....”, e cila gjendet në fshatin Greme, K. Ferizaj, me dashje direkte dhe në bashkëkryerje nga hakmarrja e paskrupullt, privuan nga jeta tani të ndjerin B.V, për shkak të mosmarrëveshjeve të mëparshme rreth një mali kontestues, në fshatin Burrnik, K.Ferizaj, e pasi që për të njëjtën çështje kontestuese me 17.02.2010, në Ferizaj kishte ndodhur rrahja në mes të akuzuarit B.N nga njëra anë dhe tani të dëmtuarve F. e V. V. nga ana tjetër, ashtu qe deri sa tani i ndjeri B.V së bashku me dy djemtë e tij – të dëmtuarit F. e V. V., ishte duke lëvizur me automjetin e tij të markës ””, në drejtim të shtëpisë së tij në fshatin Greme , e në ato çaste edhe të akuzuarit ishin duke shkuar me veturën e tyre të markës “.....”, në drejtim të Ferizajt.

Posa e vërejnë automjetin e tani të ndjerit B., i pandehuri H. N që ishte duke e drejtuar veturën “.....”, menjëherë e ka kthyer veturën e tij në rrugë duke shkuar pas veturës së të ndjerit B., e ka tejkaluar duke ia bllokuar rrugën e që të gjithë të akuzuarit dalin nga vetura e tyre, të armatosur me armë zjarri dhe atë E.N.1. me revole të tipit “ Cervena Zastava” H. N me një pushkë automatike të tipit të panjohur, M. N me pushkë automatike AK-47, si dhe Sh. e B.N me armë të zjarrit të tipit të panjohur, ku pastaj posa tani i ndjeri B. dhe të dëmtuarit F. e V. V. dalin nga vetura e tyre që ishte e bllokuar në rrugë, i pandehuri E.N.1 nga afërsia prej 2 metra ka shtënë disa herë me revole në drejtim të tani të ndjerit B. të cilin e ka qëlluar me një predhë në pjesën e jashtë të krahut të majtë e cila predhë pastaj ka depërtuar në pjesën anësore të majtë te krahavorit dhe si pasoj e dëmtimit të organeve në zgavrën e krahavorit i njëjti ka vdekur pas disa çasteve në vendin e ngjarjes.

1-b.Si me datë, kohë , vend dhe rrethanat e përshkuara si në pikën 1- a të dispozitivit, kanë tentuar ti privojnë nga jeta të dëmtuarit F. e V. V., në atë mënyrë që të akuzuarit M. N me një pushkë automatike dhe Sh.N me një armë zjarri të tipit të panjohur kanë shtënë disa herë në drejtim të të dëmtuarit F. e V. V. dhe me një predhë e kanë qëlluar të dëmtuarin V. në zonën e kofshës në këmbën e djathtë, duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore,

1-c.Që nga periudha kohore e pa vërtetuar e deri më datë 18.02.2010, rreth orës 17.30, pa leje valide për mbajtje të autorizuar të armeve, kanë mbajtur nga një armë zjarri të tipit të panjohur,

Meqë prokurori i shtetit në fjalët përfundimtare të palëve është tërhequr nga akuza për veprën penale vrasja e rëndë nga neni 147 par. 1 nën par. 9 ne bashkëkryerje nga neni 23 dhe të veprës penale mbajta në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK-së.

Shpenzimet e procedurës penale sa u përket këtyre të akuzuarve bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m i

1. Historiku i procedurës

Prokuroria e Qarkut në Prishtinë me aktakuzat PP.nr 111-2/2010 të datës 29.12.2010, i ka akuzuar E.N.1, Sh., M.N e B.N për veprën penale vrasja e rëndë nga neni 147 par. 1 nen par. 9 në bashkëkryerje lidhur me nenin 23 të KPK-së, për veprën penale vrasja e rëndë në tentativë nga neni 147 par. 1 nen par. 9 lidhur me nenin 20 dhe 23 si dhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve 328 par. 2 të KPK-se.

Me aktakuzën PP.nr 111-7/2010 të datës 10.10.2011, e ka akuzuar H. N për veprën penale vrasja e rëndë nga neni 147 par. 1 nen par. 9 lidhur me nenin 23, për veprën penale vrasja e rëndë nga neni 147 par. 1 nen par. 9 lidhur me nenin 20 dhe 23, dhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armeve 328 par. 2 të KPK-s..

Me aktakuzën PP.nr 111-2/2011 të datës 18.09.2012, e ka akuzuar E.N.2 për veprën penale vrasja e rëndë nga neni 147 par. 1 nën par. 9 n. bashkëkryerje lidhur me nenin 23, për veprën penale vrasja e rëndë në tentative nga neni 147 para 1 nën par 9 në bashkëkryerje lidhur me nenin 20 dhe 23, dhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim , apo shfrytëzim të paautorizuar të armeve nga neni 328 par. 2 të KPK-së.

Aktakuzat e ish PPQ, janë konfirmuar me aktvendimet KA.nr 547/10 të datës 27.01.2011, KA.nr 687/2011 e datës 19.10.2011 si dhe aktvendimi KA.nr 731/2012 të datës 16.10.2012.

Trupi gjykues i Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda, duke vepruar sipas këtyre aktakuzave ka mbajtur shqyrtimet gjyqësore më 15,16,17.04.2013,13,14,29.05.2013,01.07.2013,12.09.2013,01.10.2013 dhe me 3 tetor 2013, ndërkaq prokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti për Krime të Rënda Florije Shamolli – Salihu, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, ka ndryshuar aktakuzat e ish PPQ-së në Prishtinë PP.nr 111-2/2010 të datës 18.09.2010, PP.nr 111-7/2010 të datës 10.10.2011 dhe PP.nr 111-2/2010 të datës 29.11.2010, në atë mënyrë që të akuzuarin E.N.1 Nezri e ka akuzuar për vepër penale vrasja e rëndë nga neni 147 par. 1 nen par. 9 dhe për vepër penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armeve 328 par. 2 të KPK-së.

Të akuzuarit, M.N, E.N.2 e H. N i ka akuzuar për kryerjen e veprës penale vrasja e rëndë në tentativë nga neni 147 par 1 nen par 9 në bashkëkryerje lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPK-së, dhe secilin veq e veq për vepër penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armeve 328 paragraf 2 të KPK-së.¹

¹ Aktakuza e ndryshuar PPI 111-7/2010 e dates 01.10.2013.

Ndërkaq, ndaj të akuzuarve Sh. e B.N është tërhequr nga aktakuza për veprat penale që u janë vënë në barrë me aktakuzat e ish PPQ-së në Prishtinë dhe atë PP.nr 111-2/2010 të datës 29.12.2010, pra për veprën penale vrasja e rëndë nga neni 147 par 1 nën par 9 në bashkëkryerje lidhur me nenin 23, për veprën penale vrasja e rëndë në tentativë nga neni 147 par 1 nën par 9 lidhur me nenin 20 dhe 23 të KPK-së dhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve 328 paragraf 2 të KPK-së.

Në fjalët përfundimtare të palëve ka ngelur në tërësi si në aktakuzën e ndryshuar dhe ka deklaruar se me të gjitha provat e nxjerra në procedurën paraprake si dhe në shqyrtimin gjyqësor është vërtetuar se të akuzuarit i kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen me aktakuzën e ndryshuar.

Janë vërtetuar faktet relevante të çështjes penale dhe atë , të vrasjes së tani të ndjerit B.V nga i akuzuari E.N.1. me datë 18.02.2010, tentativa e vrasjes së të dëmtuarve V. e F. V., nga të akuzuarit M.N, H.N dhe E.N.2, të njëjtën kohë vend dhe datë, si dhe të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve 328 paragraf 2 të KPK-së.

Ka shtuar më tutje, se deri të ngjarja tragjike e ditës kritike, ka ardhur për faktin se i akuzuari E.N.1. me vëllezërit e tij, kishte raporte jo të mira me tani të ndjerin B.V, për shkak të mosmarrëveshjes rreth një pylli në fshatin Burrnik, Komuna Ferizaj, e që me datë 17.02.2010, në Ferizaj kishte ndodhur një rrahje në mes të B.N në njërin anë dhe të tani të dëmtuarve V. e F. V. në anën tjetër, me ç'rast të dëmtuarit e kishin goditur B.N në kokë, rast ky që i ashpërsoi edhe më tepër raportet në mes të këtyre familjeve.

Për këto arsye, deri sa tani të akuzuarit E.N.1 e M.N po e dërgonin B.n në Ferizaj të mjeku, me veturën e tipit””, e që ishin të armatosur dhe të përgatitur për të kryer hakmarrje, me të vërejtur veturën e tani të ndjerit B.V, ua prejnë rrugën, ashtu që posa dalin nga vetura ndodh një fjalosje dhe përleshje fizike e që E.N.1. me revole qëllon dy herë në drejtim të B.V duke e goditur me njërin predhë në krahun e majtë me ç'rast tani i ndjeri vdes në vendin e ngjarjes, kurse në ndërkohë edhe vazhdon rrahja në mes të të akuzuarve M.N, H.N dhe E.N.2 dhe të dëmtuarve V. e F. V.

I akuzuari M.N me pushkë automatike të tipit AK-47, kurse të akuzuarit H.N e E.N.2 të armatosur me armë të tipit dhe llojit të panjohur, gjuajnë në drejtim të të dëmtuarve V. e F. V., duke e qëlluar me një predhë të dëmtuarin V. në këmbën e djathtë e pastaj me veturën e tyre largohen nga vendi i ngjarjes.

Të gjitha këto veprime të të akuzuarve, janë vërtetuar nga mbrojtja e të akuzuarit E.N.1. e dhenë në procedurë paraprake, nga mbrojtja e të akuzuarit M.N si dhe nga dëshmitë e dëshmitarëve V. e F. V. dhe me provat materiale, duke filluar prej shikimit të vendit të

ngjarjes, raportit i autopsisë, ekspertiza balistike e armeve te sekuestruara e qe është konstatuar se plaga vdekjeprurëse e tani te ndjerit B.V, është shkaktuar nga arma me tytë te shkurtë, gëzhojat e hasura ne vendin e ngjarjes i përkasin armës së gjatë – pushkës automatike AK -47 që është sekuestruar po ashtu nga Policia, pra nga raporti i balistikës është konstatuar se ditën kritike ne ngjarje janë përfshirë – janë përdorur 2 armë dhe atë një revole M 57 kal 7.62 x25 mm dhe një pushke automatike AK -47 kal 7.62 x 39 mm, po ashtu ne vendin e ngjarjes janë gjetur dy gëzhoja të revoles dhe ty gëzhoja te pushkës automatike.

Mbi këto fakte, prokurori e ka mbështetur aktakuzën ndaj të akuzuarve, si dhe në dëshmitë e dëshmitarëve V. e F. V., të cilët kanë deklaruar se ditën kritike të akuzuarit me veturën e tyre ua kanë prerë rrugën, përderisa të dëmtuarit udhëtonin me veturën e tyre të markës “Jeep Shiroka” qe e ka vozitur tani i ndjeri babai i tyre B.V.

Me këtë veturë udhëtonin në drejtimin Ferizaj – Gaçkë, nga vetura e të akuzuarve kanë dal i akuzuari E.N.1 me revole ne dorë, të akuzuarit M.N dhe E.N.2, kurse H. N ka ardhur nga prapa veturës ka filluar rrahja e që menjëherë kanë filluar të shtënat nga te akuzuarit nga të cilat është qëlluar për vdekje tani i ndjeri B.V dhe është plagosur ne këmbë i dëmtuari V. V..

I ka propozuar trupit gjykues që të akuzuarit ti shpall fajtor për veprat penale për te cilat akuzohen me akuzën e ndryshuar dhe ti dënoj me dënimet e parapara sipas ligjit.

Te dëmtuarit M. V. dhe V. V. kane deklaruar se i bashkëngjiten ndjekjes penale ndaj te akuzuarve E.N.1, M.N, H.N dhe E.N.2 dhe atë për vrasjen e bashkëshortit-babait nga ana e të akuzuarit E.N.1, kurse i dëmtuari V. për vrasjen në tentativë ndaj tij të kryer nga të akuzuarit M.N, H.N dhe E.N.2. Kanë parashtruar kërkesë për kompensim të dëmit mbi këto baza në shumë dhe vlerë të pa përcaktuar.

2.Mbrojtja e të akuzuarve E.N.1, M.N, H.N e E.N.2

Te akuzuarit ne shqyrtimin gjyqësor nuk e kanë pranuar fajësinë për veprat penale për te cilat akuzohen me aktakuzat e ish PPQ ne Prishtinë dhe sipas aktakuzës se ndryshuar të prokurorit te shtetit.

I akuzuari E.N.1., në shqyrtimin gjyqësor ne mbrojtjen e tij ka deklaruar se me 18.02.2013, pasi që e ka kryer orarin e punës – roje pylli, rreth orës 17.00 ka shkuar ne shtëpinë e tij ne fshatin Gaçkë, aty ishin djemtë e vëllait dhe atë M. dhe B.N. Meqë B... duhej për te kryer një kontroll mjekësore – ngase një ditë me parë kishte marr lëndime nga te dëmtuarit V. e F. V. gjatë rrahjes, i akuzuari me veturën e markës “.....”, është nisur bashk me B. e M. për të shkuar në Ferizaj.

Veturën e ka vozitur i akuzuari E.N.1, dhe me të arritur në dalje të fshatit Greme, përball tyre është ndalur vetura e markës “.....”, nga e cila kanë dal B.V dhe dy djemtë e tij. I akuzuari ka dal nga vetura e tij, meqë nuk ka mundur të vazhdojë rrugën pa u larguar njëra

nga veturat, për shkak se rruga ishte e ngushtë, B.V ka dal nga vetura e tij me revole në dorë, i akuzuari e ka lutur që të ia liroj rrugën duke e njoftuar se e ka personin e sëmurë duke e dërguar te mjeku, ndërkaq B. ia ka kthyer se “ *me ty nuk kam punë dhe nuk e kam ditur që je ti*”, ne ndërkohë i akuzuari deklaroi se ka dëgjuar krismat e armeve dhe atë të revoles dhe të pushkës automatike.

Ka deklaruar në mbrojtjen e tij, se nuk ka pasur armë me vete në momentin kritik, M. ka dal prej veturës ku ishte i ulur në ulësen e parë, kurse B.... nuk ka dalur nga vetura, duke deklaruar se nuk din se çka ka ndodhur pastaj në ato momente, kur kanë shkrepur armët nuk e dinë se kush ka gjuajtur, por që është vrarë tani i ndjeri B. ka kuptuar nga krismat e armëve.

Ka deklaruar po ashtu se nuk ka mundur të shoh se a kanë pasur diçka në dorë tani të dëmtuarit V. e F. V., kur kanë dal prej veturës së tyre, po ashtu ka deklaruar se nuk ka njohuri se kush ka shtënë dhe kush e ka vrarë tani të ndjerin B.V.

Pas krismave të armeve, ka hipur në veturën e tij dhe bashk me M. e B është kthyer në fshatin Gaqkë, ne shtëpinë e tij e pastaj kanë ardh policia dhe e kanë arrestuar.

Me tani të ndjerin B.V, nuk ka pas raporte të këqija personalisht përpara ndodhjes së rastit, kurse familjaret e tij – vëllezërit dhe nipat kanë pasur mosmarrëveshje me B.V rreth një mali në fshatin Burrnik dhe kanë ndërmjetësuar njerëzit për ti pajtuar, por pajtimi i tillë nuk është arritur.

I akuzuari M. N në mbrojtjen e dhënë në shqyrtimin gjyqësor, ka deklaruar se me 18.02.2010, bashk me agjen e tij E.N.1i, prej fshatit Gaqkë janë nisur për Ferizaj, për të shkuar të mjeku meqë vëllai i tij B. kishte për të kryer një kontroll ngase një ditë me parë kishte marr lëndime në kokë nga F. V., kanë udhëtuar me veturën e markës “.....” që e ka vozitur agja i tij – tani i akuzuari E.N.1, kurse vet është ulur në ulësen e përparme ndërkaq vëllai i tij B..... në ulësen e pasme të veturës.

Ne fshatin Greme, përball mobilierisë “.....” nga drejtimi i kundërt ua ka zënë rrugën B.V me veturën e tij të markës “Jepp Shiroke” duke u ndalur përball veturës së tyre.

Nga vetura ka dal B.V dhe dy djemtë e tij dhe atë V. e F., kurse prej veturës së E.N.1, ka dal fillimisht E.N.1, ka biseduar me B., duke i thënë që t’ia liroj rrugën sepse e ka njeriun e sëmurë në veturë, B.i ka sharë dhe u ka thënë djemve të tij “ *prene M. sepse unë do ta kurtalisi E.N.1*”, që në dorë kishte një revole, V. në dorë ka pasur një shkop bejsbolli, kurse F. në dorë ka pasur sëpatë, dhe me të dal prej veturës M. e kanë sulmuar, në atë mënyrë që F. e ka goditur me bisht dhe qyk te sëpatës në krahun e djathtë.

Me tutje ka deklaruar se, nga vetura e ka marr pushkën automatike të cilën e kishte vendosur më përpara dhe atë nën ulësen e parë, dhe kur V. e F. kanë tentuar që ta sulmojnë për herë të dytë, atëherë ka gjuajtur në drejtim të tyre dhe e ka vërejtur se e ka goditur V.in i cili është rrezuar në tokë. Në vend të ngjarjes ka dëgjuar edhe të shtëna të tjera, por për shkak të situatës së krijuar nuk ka mundur të dalloj se prej çfarë armësh kanë dalur të shtënat, se ka

qenë i hutuar, por nuk ka parë se kush ka gjuajtur. Po ashtu ka deklaruar se nuk ka vërejtur se çka ka pas në dorë i akuzuari E.N.1, e që pas këtyre krismave i akuzuari E.N.1 e ka kthyer menjëherë veturën në të cilën ka hipur edhe i akuzuari M.N, e ku ishte edhe B i cili fare nuk ka zbritur nga vetura, e pastaj kanë shkuar në shtëpinë e E.N.1it në fshatin Gaçkë.

Ka deklaruar se para se të niseshin për Ferizaj, nën ulësen e parë të veturës e ka vendosur pushkën automatike. Se deri të ngjarja kritike ka ardhur për shkak se raportet e familjes N... me familjen V. kanë qenë të acaruar për shkak të një mosmarrëveshje për malin në fshatin Burrnik, e konkretisht agja i tij H. me B. dhe që një dite para ngjarjes kritike , pra me 17.02.2010 djemtë e B. dhe atë V. e F. në Ferizaj e kanë rrahur vëllain e tij B duke i shkaktuar lëndime në kokë.

I akuzuari H. N ,në mbrojtjen e tij në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se më datën 18.02.2010 ka qenë në shtëpinë e tij në fshatin Burrnik, ndërkaq rreth orës 20.00 ka kuptuar se në fshatin Greme , ka ndodhur një problem në mes të vëllaut të tij E.N.1, djalit të vëllaut M. dhe të familjes V..

Ka deklaruar se më tani të ndjerin B.V para 4 viteve (përpara se me ndodh ky rast), ka pasur një mosmarrëveshje rreth një mali të shtetit në fshatin Burrnik,me ç'rast edhe janë rrahur me të njëjtin , e që pastaj kanë ndërmjetësuar njerëzit sipas traditave për ti "*pajtuar*", por nuk kanë arritur marrëveshje rreth pajtimit, edhe pse tani i ndjeri B. ka qenë nip i kushërinjëve të familjes N, se deklaratat e të dëmtuarve V. e F. V. për involvimin e tij në ngjarjen kritike të datës 18.02.2010, janë të pa baza dhe janë për shkakun se i akuzuari para disa viteve ishte rrahur me tani të ndjerin B.V dhe djemtë e tij.

Në mbrojtjen e tij ka deklaruar se ditën kritike, tërë ditën është marrë me punët rreth shtëpisë në fshatin Burrnik, Komuna Ferizaj, se fare nuk ka qenë në vendin e ngjarjes dhe se deri në momentin kur është arrestuar me 02.08.2010, ka kryer punët e tij, ka qëndruar në shtëpi dhe para kësaj date nuk e ka ftuar apo kërkuar organi i ndjekjes.

I akuzuari E.N.2 në mbrojtjen e dhënë në shqyrtimin gjyqësor, ka deklaruar se jeton në fshatin Gaçkë, Komuna Ferizaj, me prind, vëllezërit B , S dhe E.N.1. të cilët po ashtu kanë shtëpi të përbashkët edhe në fshatin Burrnik. Ditën e ngjarjes kritike pra me 18.02.2010, rreth orës 15.00, ka shkuar në Kaçanik për të marrë një kafshë- viç të cilin e kishte blerë dhe e ka transportuar me kamionin e tij në fshatin Gaçkë rreth orës 18.30, e që prej anëtarëve të familjes ka kuptuar se diçka kishte ndodhur e që në ndërkohë ka ardhur një patrullë e policisë e që i akuzuari pastaj kuptoi se kishte ndodhur rasti në fshatin Greme.

Ka deklaruar se personalisht me tani të ndjerin B.V nuk ka pasur ndonjë të keqe, por probleme ka pasur vëllai i tij H. N dhe janë rrahur me tani të ndjerin B. për shkak të një mali në fshatin Burrnik.

Kur është kthyer prej Kaçanikut, në oborrin e shtëpisë ishte vetura “”, e cila ka qenë e regjistruar në emër të vëllait të tij E.N.1., kurse e kanë vozitur edhe anëtarët e tjerë të familjes sipas nevojës.

Djali i vëllait Sh.- B që jeton në fshatin Burrnik, ka ardhur në shtëpinë e tij me 17.02.2010, e që në kokë kishte një fashë dhe i ka treguar se djemtë e B.V e kanë rrahur dhe i kanë shkaktuar lëndime me datën 17.02.2010 në Ferizaj, dhe se më datë 18.02.2010 i njëjti – pra B. ka pas për ta kryer një kontroll te mjeku, por nuk ka njohuri se me kë është nisur për të shkuar te mjeku në Ferizaj sepse atë ditë prej orës 15.00 deri në mbrëmje nuk ka qenë në shtëpi. Nuk ka njohuri se për çfarë arsye të dëmtuarit V. e F. V. e ngarkojnë për involvim në ngjarjen e ditës kritike të 18 shkurtit 2010.

3.Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Meqë të akuzuarit nuk e kanë pranuar fajësinë për veprat penale sipas pretendimeve të akuzës së prokurorit, gjykata në shqyrtimin gjyqësor ka shtjelluar provat e akuzës, provat e siguruara nga gjykata sipas detyrës zyrtare dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe në ndërlidhje reciproke njëra me tjetrën në kuptim të dispozitës së nenit 387 par 2 të KPPK-së, vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjendjen faktike gjykata e vërtetoi nga provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor dhe atë :

- Pjesërisht nga mbrojtja e të akuzuarve e në veçanti nga mbrojtja e të akuzuarit E.N.1. e dhënë në procedurë paraprake dhe nga mbrojtja e të akuzuarit M. N e dhënë po ashtu në procedurë paraprake dhe në shqyrtimin gjyqësor,
- Nga dëshmitë e dëshmitarëve V., F. e M. V., dhe atë pjesërisht nga dëshmitë e tyre të dhëna gjatë fazave të procedurës penale dhe në shqyrtimin gjyqësor,
- Nga ekzaminimi i ekspertizës – zyra për persona të zhdukur MA10052 të datës 19.02.2010,
- Raporti i ekspertizës për armët e zjarrit të datës 01.10.2010,
- Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes VN.nr 13-10/02 me skicën , legjendën dhe fotoalbumin,
- Mendimi i ekspertit mjeko ligjor për natyrën e lëndimeve të të dëmtuarve V. e F. V.
- Ekspertiza e ekspertit të balistikës dhe ekspertit mjeko ligjor e datës 21.06.2013 dhe mendimi i dhënë në shqyrtimin gjyqësor,

4.Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor dhe të gjeturat faktike të gjykatës

Trupi gjykues shqyrtoi të gjitha provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor duke i vlerësuar në mënyrë profesionale dhe ligjore dhe konstatoi:

Është arritur që plotësisht dhe përtej çdo dyshimi, të vërtetohet gjendja faktike e ndodhur me 18.02.2010.

Në këtë kontest trupi gjykues, fillimisht, vlerësoi se janë vërtetuar në mënyrë të pa kontestueshme këto fakte:

a.Se ditën kritike të datës 18.02.2010, në rrugën Ferizaj – Gaçkë, afër mobilierisë “.....”, në fshatin Greme, Komuna Ferizaj, ka ndodhur një përleshje fizike në mes të dy palëve të involvuara dhe atë anëtarëve të familjes N.... dhe anëtarëve të familjes V..

b.Se janë përdorur armë të zjarrit,

c.Dhe që nga një predhë e armës është qëlluar tani i ndjeri B.V, ku si pasojë e goditjes së predhës ka humbur jetën në vendin e ngjarjes,

d.Se po ashtu plagë në kofshën e këmbës së djathtë ka marr i dëmtuari V. V. që është qëlluar po ashtu nga predha e armës së zjarrit.

Trupi gjykues, në bazë të provave të çështjes penale, vlerësoi dhe pati për detyrë të ndriçoj gjendjen faktike duke vlerësuar versionet e paraqitura nga palët në procedurë dhe atë nga prokurori i shtetit me versionin sipas aktakuzës se vrasjen e tani të ndjerit B.V e ka kryer i akuzuari E.N.1., kurse të akuzuarit M.N, H.N e E.N.2 të kenë shtënë me armë në drejtim të të dëmtuarve V. e F. V. si dhe versionet e paraqitura nga të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre se nuk dihet kush e ka kryer vrasjen e B.V, dhe se të akuzuarit H.N e E.N.1 nuk kanë marr pjesë fare në këtë ngjarje.

I gjendur në mes të këtyre versioneve, trupi gjykues, vlerësoi të gjitha provat, pretendimet e palëve dhe provat materiale dhe në bazë të këtyre vërtetoi gjendjen faktike e që arsyetimin e aktgjykimit pikërisht do ta përqendroj në sqarimin e këtyre rrethanave të cilat trupin gjykues e binden për një vendosje të tillë të përshkruar si në dispozitiv.

I dëmtuari V. V., i dëgjuar ne cilësi të dëshmitarit okular të ngjarjes, në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se deri te ngjarja e ditës kritike ka ardhur për shkak të konflikteve të mëparshme që i ka pasur babai i tij B.V me H. N dhe vëllezërit e tij, e që para katër viteve edhe janë rrahur për shkak të një mali ne fshatin Burrnik, e që po ashtu me datë 17.02.2010, në Ferizaj janë rrahur me B.N, me ç’rast dëshmitari F. të njëjtin e ka goditur në kokë me qykë të thikës.

Edhe i dëmtuari F. V., i dëgjuar në cilësi të dëshmitarit okular ka përshkruar ngjarjen kritike dhe raportet që i kanë paraprirë kësaj ngjarje, duke shtuar se kishin raporte jo të mira me familjen N, për shkak të malit në fshatin Burrnik ku ishin rrahur H. N dhe babai i tij tani i ndjeri B., e pastaj me datën 17.02.2010 në Ferizaj janë rrahur me B.N me ç'rast dëshmitari të njëjtin e ka goditur me qykë të thikës në kokë.

Pastaj, dëshmitarët kanë përshkruar sipas versioneve të tyre rrjedhën e ngjarjes të datës 18.02.2010, duke deklaruar se në orët e pasdites të kësaj date, ishin duke u kthyer në drejtim të fshatit Greme për të shkuar në shtëpinë e tyre, me veturën e markës “” që e ka vozitur babai i tyre tani i ndjeri B.V. Me të arritur përball mobilierisë “” në hyrje të fshatit Greme, nga drejtimi i kundërt pra nga drejtimi Gaçkë- Ferizaj, kanë vërejtur veturën e markës “” që ishte duke lëvizur në drejtim të Ferizajt, dhe pas një kohë të shkurtër, kjo veturë i ka tejkalar (duke e kthyer drejtimin e lëvizjes), ua ka prerë rrugën, është ndalur dhe nga kjo veturë ka dal E.N.1. me revole në dorë, E.N.2 me pushkë – kallash dhe M. N qe ka pasur diçka në dorë, ndërkaq prapa veturës së tyre ka dal i akuzuari H. N i cili po ashtu në dorë kishte pushkë automatike.

Nga vetura e të dëmtuarve, ka dal babai i tyre B.V duke thënë “ *çka u ba*”, kurse i akuzuari E.N.1 ka bërë titur “ *mos livritni* ” , që menjëherë dëshmitarët kanë dëgjuar të shtënat e armeve dhe atë të shtëna prej revoles dhe të pushkës automatike , nga të cilat të shtëna dëshmitari V. është plagosur në kofshën e këmbës së djathtë dhe është rrezuar në kanal in anësor të rrugës duke deklaruar se të njëjtin e ka plagosur i akuzuari E.N.2.

Ngjarja, sipas dëshmitarëve është zhvilluar shpejt, ka pasur shumë të shtëna , kurse dëshmitari V. ka deklaruar se nuk e ka parë se kush ka gjuajtur në drejtim të babait të tij, kurse i akuzuari E.N.1 ka thënë “ *vraje qenin*” (duke aluduar në të dëmtuarin F.), dëshmitari V. pastaj ka sqaruar se H. N e ka ndjekur pas deri sa dëshmitari është rrezuar në kanal të rrugës, e që i akuzuari ka pas në dorë pushkë automatike por nuk ka gjuajtur në dëshmitarin.

Edhe dëshmitari F. V. në dëshminë e tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor , ka përshkruar ndodhjen e ngjarjes kritike që përafërsisht është identike me dëshminë e dëshmitarit V. V., se nga vetura e cila ua ka prerë rrugën, kanë dal E.N.1i, M. dhe E.N.2i, kurse prapa veturës ka dal H. N e që E.N.1. ka pas në dorë diçka të shkurtë, kurse H. N e ka gjuajtur me pushkë – kallash babanë e tij, i cili është rrezuar në tokë menjëherë, kurse i akuzuari E.N.2 këtë dëshmitar e ka gjuajtur me pushkë – kallash duke e qëlluar në këmbë, për të vazhduar me tutje se aty ka pasur shumë të shtëna, por që dëshmitari është larguar nga vendi i ngjarjes duke ikur në drejtim të mobilierisë “”.

Ky dëshmitar ka deklaruar se, i akuzuari M.N kishte diçka të gjatë në dorë, por nuk e din se çka ka qenë, ndërkaq kur dëshmitari ka dal prej veturës se tij në dorë e ka pas sëpatën, por nuk e ka goditur askënd.

Trupi gjykues me kujdes të veçantë vlerësoi dëshmitë e dëshmitarëve në kompleksitetin e çështjes dhe të vlerësimit të të gjitha provave të tjera dhe erdhi në përfundim se dëshmitë e këtyre dy dëshmitarëve pothuajse janë të përafërta rreth përshkrimit të ngjarjes të ndodhur në ditën kritike – kjo sa u përket dëshmimeve të dëshmitarëve të dhëna në shqyrtimin gjyqësor, të pjesëmarrjes se të akuzuarve në këtë ngjarje, por njëherit me dallime në përshkrimin e veprimeve të të akuzuarve dhe në involvimin e tyre në veprimet inkriminuese, e pastaj trupi gjykues nxori si konkludim se dëshmitë e dëshmitarëve në shqyrtimin gjyqësor kanë zbardhur në veçanti rrethanat – mosmarrëveshjet në mes të familjes N.... dhe V., konfliktin lidhur me malin, rrahjen në mes të H. dhe B.V e pastaj edhe rrahjen e B.N nga të dëmtuarit V. e F. V. një ditë përpara ngjarjes kritike, në këtë kontekst edhe mënyrën dhe disa rrethana të ngjarjes kritike të datës 18.02.2010 si pjesëmarrjen e të akuzuarve E.N.1, M.N, H.N dhe E.N.2 por nga këto dëshmi nuk janë konkretizuar qartë dhe saktë veprimet konkrete të të akuzuarve në ngjarjen kritike.

Kjo edhe ishte e kuptueshme nga ana e trupit gjykues duke pas parasysh faktin se dëshmitarët janë të moshës së re, zhvillimi i shpejt i ngjarjes dhe pamundësia e dëshmitarëve për të perceptuar në mënyrë të saktë veprimet e të akuzuarve se dëshmitarët kanë përjetuar një ngjarje të rëndë në momentin kritik të datës 18.02.2010 si pasojë e humbjes së prindit – babait B.V, plagosjes së dëshmitarit V. V. dhe gjendja e tyre emocionale si pasojë e këtyre rrethanave është e kuptueshme, por frustrimi i tyre nga ngjarja kritike si pas bindjes të trupit gjykues dëshmitarëve u ka dhënë emocione duke i motivuar që të japin deklaratatë të tilla akuzuese ndaj të gjithë të akuzuarve (edhe përkundër faktit se janë njoftuar me obligimin ligjor si dëshmitar dhe me pasojat ligjore të dëshmimeve jo te vërteta).

Si të kuptohen ndryshe dëshmitë e tilla të dëshmitarëve, të dhëna në shqyrtimin gjyqësor, kur krahasuar me deklaratatë e dhëna në procedurë paraprake në shumë pjesë janë në disëharmoni dhe me devijime të mëdha, sa i përket përfshirjes së të akuzuarve E.N.1, M.N, H.N e E.N.2 në ngjarjen kritike dhe veprimet e tyre “ *H. ka gjuajtur me kallash ne drejtim te babës* “ deklaroi dëshmitari F. V. në shqyrtimin gjyqësor dhe “ *pasi ka gjuajt H., baba ka ra menjëherë ne tokë*”, kurse dëshmitari para prokurorit me 06.08.2010 deklaroi “ *prej veturës së tyre kanë dal H., E.N.1i, B., M., Sh. dhe E.N.2i të gjithë kanë pas armë, fillimisht ka dal E.N.1i me revole në dorë, H. me pushkë të gjatë, e kanë gjujt babën tim*”. Po në këtë deklaratë dëshmitari pastaj shton “*mua me kanë gjujt tre persona, Sh.a, B. e M.*”, ndërkaq në shqyrtimin gjyqësor deklaroi “*mua me ka gjuajt me kallash E.N.2 dhe më ka rrok ne këmbën e majtë*”,² por lëndimi i tij me predhë të armës në ditën kritike nuk është konstatuar me asnjë provë dhe as me ekspertizën – konstatimin e ekspertit mjeko ligjor i datës 14.12.2010.

Edhe në mes të dëshmimeve të dëshmitarit V. V. e dhënë në shqyrtimin gjyqësor dhe në procedurë paraprake, paraqiten divergjenca të mëdha “*unë nuk e kam pa kush e ka gjuajt*

² Pjesë nga deklaratatë e dëshmitarit F.V e dhënë ne PPQ në Prishtinë me 06.08.2010

babën tim dhe vëllain F.”, deklaroi dëshmitari në shqyrtimin gjyqësor, por “ *e di që mua me ka plagosë E.N.2 me kallash*”.³

Në deklaratën e dhënë në PPQ në Prishtinë me 04.08.2010, dëshmitari deklaroi “ *prej veturës së tyre kanë dal E.N.1i, E.N.2i, M. dhe H. , së pari ka gjuajt me kallash E.N.2i dhe më ka qellu në këmbë*”, kurse nuk e ka pa se kush e ka gjuajtur babanë e tij.⁴

Ndërkaq që të dy dëshmitarët në shqyrtimin gjyqësor, kanë deklaruar se H. N në momentin kritik ka dal prapa veturës së tyre, pra jo nga vetura ku ishin të akuzuarit e tjerë.

Për të gjitha këto devijime të dëshmive të dëshmitarëve gjatë fazave të procedurës, dëshmitarët në shqyrtimin gjyqësor kanë deklaruar se e vërteta është ajo që po deklarojnë në shqyrtimin gjyqësor, duke shtuar “ *se tani dëshirojmë ta tregojmë të vërtetën që ka ndodhur në ngjarjen kritike të datës 18.02.2010*”.⁵

Nga këto që u cekën, trupi gjykues konsideron se të dëshmitarët (njëherit edhe të dëmtuar të këtij rasti), vërehet dhe është vërtetuar ekzistimi i tendencës për të ekzagjeruar veprimet e të akuzuarve në veçanti të të akuzuarve H.N , M.N dhe E.N.2.

Megjithatë, trupi gjykues edhe pse i gjendur në mes të dy lloje të deklaratave kontradiktore të këtyre dëshmitarëve, krahasuar njëra me tjetrën dhe deklaratat kontradiktore të secilit dëshmitar brenda vetvetes, deklarimeve të tilla pjesërisht ua falë B.n duke i ndërlidhur me provat e tjera dhe argumentet që do të paraqesim në vijim:

Së pari, dëshmitë e tilla vërtetojnë në mënyrë të pa kontestueshme se me datën 18.02.2010, ka ndodhur ngjarja kritike e përshkruar si në dispozitiv, se ka ndodhur përleshje fizike, janë përdorur mjete të forta si sëpatë e dru, janë përdorur po ashtu edhe armë të zjarrit nga ana e të akuzuarve, nga të cilat ka humbur jetën tani i ndjeri B.V dhe është plagosur i dëmtuari V. V..

Që kësaj ngjarje i kanë paraprirë raportet e acaruar në mes të këtyre dy familjeve, fakte këto që janë zbardhur edhe nga vet mbrojtja e të akuzuarve E.N.1, M.N, H.N dhe E.N.2 N....., ndërkaq sa i përket raporteve të acaruar kjo është vërtetuar në përgjithësi nga të gjithë të akuzuarit që e kanë pohuar ekzistimin e këtyre raporteve siç e kanë pohuar edhe lëndimin e B.N (vëlla i të akuzuarit M.N- djalë vëllai i të akuzuarve E.N.1, H.N dhe E.N.2), nga të dëmtuarit V. e F. V. dhe atë një ditë përpara se të ndodh ngjarja kritike e datës 18.02.2010.

Trupi gjykues për të konstatuar se cili nga të akuzuarit ka shtënë në momentin kritik në drejtim të të ndjerit B.V, shqyrtoi përpos dëshmive të dëshmitarëve edhe mbrojtjen e të akuzuarve, e në veçanti mbrojtjen e të akuzuarit E.N.1. të dhënë në procedurë paraprake në

³ Pjesë nga deklaratat e dëshmitarit V.V e dhënë në shqyrtimin gjyqësor me datë 15.04.2013

⁴ Pjesë e deklaratës së dëshmitarit V.V e dhënë në PPQ në Prishtinë me 04.10.2010

⁵ Sikur në fustonoten numer 3

PPQ ne Prishtinë me 30.03.2010 në prani të avokateve mbrojtës, se ditën kritike në orët e pasdites prej shtëpisë së tij në fshatin Greme, është nisur për Ferizaj me veturën e markës “.....”, për ta dërguar te mjeku djalit e vëllait B. të cilin një ditë me parë e kishin rrahur dhe i kishin shkaktuar lëndime ne kokë te dëmtuarit V. e F. V..

Në veturë ishte edhe M. dhe me të arritur afër mobilierisë “.....”, në fshatin Greme, i ka bllokuar rrugën B.Vt me veturën e tij, dhe pasi kanë dal nga veturat i akuzuari E.N.1 e ka lutur që t’ia liroj rrugën, por i njëjti ka vazhduar ti kërcënoj duke i thënë djalit të tij që ta sulmojnë M.n sepse ky merret me te akuzuarin E.N.1.

Deklarimi i tillë i të akuzuarit E.N.1, është përafërsisht identik me deklarinimin e dhënë në shqyrtimin gjyqësor , ku i akuzuari pohon faktin se pasi kanë dal nga veturat dhe pasi janë fjalosur me B.V dhe djemtë e tij, ka ndëgjuar të shtëna të armëve por vet nuk ka shkrepur nga arma – mbrojtje kjo e dhënë në shqyrtimin gjyqësor , por që në mbrojtjen e dhënë para prokurorit të qarkut ne Prishtinë i njëjti ka pranuar faktin se ka shtënë me revole TT në drejtim të B.V dhe djemve të tij, dhe atë dy herë ka shkrepur nga kjo revole dhe e ka goditur B.in “ *unë me vete kam pas revole te tipit TT, kal 7,62mm dhe kam shtënë dy here ne drejtim te B.it dhe djemve të tij dhe jam ne dijeni se e kam godit B.in*”⁶

Ndërkaq, edhe të dëmtuarit V. e F. V., kanë deklaruar se i akuzuari E.N.1. në momentin kritik kur ka dal prej veturës se tij në dorë e ka pas revolen.

Nga raporti i shikimit të vendit të ngjarjes përpos tjerash , konstatohet se janë sekuestruar 2 armë të zjarrit dhe atë një revole M 57 TT cal 7.62 mm, numër serik H-103489 dhe një pushkë automatike AK 47 me numër serik, që në vendin e ngjarjes po ashtu janë gjetur dy gëzhoja të kalibrit 7.62x25mm dhe dy gëzhoja te kalibrit 7.62x39mm⁷.

Në bazë të raportit të ekspertizës – laboratorit të forenzikës të datës 01.11.2010, konstatohet se dëshmitë D#4 dhe D#5- që janë dy gëzhoja te kal. 7.62x25mm janë gjuajtur nga revolja M57 TT me numër serik H-103489 e kalibrit 7.62x25 mm, kurse nga dëshmitë D#7 dhe D#8 që janë dy gëzhoja të kalibrit 7.62x39 mm, është konstatuar se janë gjuajtur nga pushka automatike AK 47 me numër serik 11111457 kalibrit 7.62x39 mm⁸.

Nga raporti i autopsisë- Zyra për Persona të Zhdukur dhe Mjekësi Ligjore MA 10052 të datës 23.02.2010, është konstatuar se i ndjeri B.V ka vdekur nga lëndimet e shkaktuara nga arma e zjarrit dhe atë nga veprimi dinamik i predhës që e ka goditur në pjesën anësore të krahut të majtë, ka depërtuar në pjesën anësore – aspektin e majtë të kraharorit, duke kaluar nëpër zgavrën e kraharorit mes brinjëve dhe deri te dalja e predhës në anën e prapme të djathtë të kraharorit dhe ka mundësi të ketë qenë një predhë me plagë shqyese⁹

⁶ Pjese e mbrojtjes se te akuzuarit E.N e dhene para PPQ ne Prishtine me date 30.03.2010

⁷ Raporti I shikimit te vendit te ngjarjes

⁸ Ekspertiza balisitike e armeve e dates 01.11.2010

⁹ Raporti I autopsisies I dates 23.02.2010.

Për të evituar dilemat rreth faktit se nga cili kalibër i predhës është shkaktuar vdekja e tani të ndjerit B.V, trupi gjykues ka kërkuar mendimin e ekspertit të balistikës dhe të ekspertit mjeko ligjor të cilët në ekspertizën me shkrim të datës 21.06.2013 dhe të arsyetuar edhe në shqyrtimin gjyqësor , kanë dhënë konstatimin se tani i ndjeri B.V ka vdekur si pasojë e gjakderdhjes së shpejtë, të brendshme, të shkaktuar nga veprimi dinamik i predhës të hedhur nga armë zjarri me tytë të shkurtër- revole e kalibrit 7.62x25 mm.

Provat materiale në drejtim të ndriçimit të faktit se nga cili lloj i predhës është shkaktuar vdekja e tani të ndjerit B.V sqarohen se tani i ndjeri është qëlluar me dy predha të armës së shkurtë, që njëra e ka qëlluar në pjesën e poshtme të krahut të majtë nën bërryl, kurse tjetra predhë në pjesën mbi bërryl të krahut po ashtu të majtë, duke depërtuar neper anën e majte të krahorit dhe duke dalur në anën e djathtë po ashtu të krahorit, e që predha ishte e armës së shkurtë – revole e kalibrit 7.62x25 mm që në fakt kur ndërlidhen me provat e tjera, që trupi gjykues i vlerësoi si ndërlidhje reciproke për të konstatuar këtë fakt, atëherë konstatimi përfundimtar del se në tani të ndjerin B.V ka shtënë me revole i akuzuari E.N.1. dhe atë dy herë duke qëlluar me njëren predhë siç u përshkrua më lartë e nga e cila i njëjti ka ndërruar jetë në vendin e ngjarjes.

5.Vlerësimi i mbrojtjes se të akuzuarit E.N.1. dhe i mbrojtësit të tij

Përfundimi i tillë i trupit gjykues se vrasjen e tani të ndjerit e ka kryer i akuzuari E.N.1, u nxor kur provat materiale dhe ekspertizat u ndërlidhen me deklaratat e dëshmitarëve V. e F. V. te cilët në çdo fazë të procedurës si dhe në shqyrtimin gjyqësor kanë deklaruar se kur ka zbritur nga vetura E.N.1. në dorë e ka pas revolen dhe është fjalos me babanë e tyre kur ka qenë shumë afër të njëjtit, e që kur këtyre u shtohet edhe mbrojtja e të akuzuarit E.N.1. e dhënë në PPQ në Prishtinë me date 30.03.2010, në praninë e dy avokateve mbrojtës “ *unë me vete kam pas revole te tipit TT, kal 7.62 mm, dhe kam shti dy her ne drejtim te B.it dhe djemve te tij dhe jam ne dijeni se kam godit B.in*”, përfundimisht trupi gjykues konstatoi bindshëm se kryesi i veprës penale të vrasjes së rëndë të kryer me 18.02.2010 ndaj tani të ndjerit B.V është i akuzuari E.N.1., edhe përkundër faktit se i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor nuk e ka pranuar kryerjen e kësaj vepre penale.

Trupi gjykues më tutje vlerësoi veprimet inkriminuese të të akuzuarve M.N H.N dhe E.N.2 në ngjarjen kritike,dhe pas analizimit të të gjitha provave, vlerësimit të dëshmive të dëshmitarëve, vlerësimit të mbrojtjes se të akuzuarve të dhëna në të gjitha fazat e procedurës penale si dhe në shqyrtimin gjyqësor, konstatoi gjendjen faktike të cekur si në dispozitiv.

Mbrojtja e të akuzuarit M. N e dhënë para prokurorit të PPQ në Prishtinë me 15.04.2010, në prani të avokatit si dhe mbrojtja e tij e dhënë në shqyrtimin gjyqësor, janë të

përafërta, që i akuzuari ka pranuar se nga vetura e tyre e ka marr pushkën automatike dhe ka shtënë në drejtim të të dëmtuarit V. e F. dhe atë dy herë, duke e qëlluar V., në këmbë.

E ndërlidhur, kjo mbrojtje edhe me provat materiale, si raporti i shikimit të vendit të ngjarjes ku janë gjetur në vendin e ngjarjes dy gëzhoja të pushkës automatike, sekuestrimit të një pushke automatike, e që pastaj gjatë ekspertizës balistike është konstatuar se gëzhojat e tilla i takojnë të njëjtës pushkë automatike të gjetur në vendin e ngjarjes, faktit se te i dëmtuari V. është konstatuar një plagë tej shkuese nga armë zjarri, në zonën e kofshës së djathtë – që është vlerësuar si lëndim i lehtë trupor.

Kur këtyre u shtohen edhe deklaratat e të dëmtuarve V. e F. V, që M. N në momentin kritik kur ka dal nga vetura ka pas diçka të gjatë në dorë, kurse dëshmitari F. se edhe M. ka gjuajtur me armë në drejtim të tij, të gjitha këto ndërlidhje të provave ,bindën padyshim trupin gjykues se veprimet e të akuzuarit M. N në ngjarjen e ditës kritike , ishin padyshim të drejtuara në tentimin e tij që ti privoj nga jeta tani të dëmtuarit V. e F. V..

Si të shpjegohen dhe të sqarohen ndryshe veprimet e të akuzuarit M.N, në kompleksitetin e ngjarjes kritike edhe përkundër faktit se i njëjti në mbrojtjen e tij, ka deklaruar se e kanë sulmuar të dëmtuarit V. e F. dhe atë njeri me sëpatë e tjetri me shkop-dru , duke e goditur me bisht të sëpatës , kurse i akuzuari e ka marr pushkën automatike, që e kishte vendosur në veturë dhe ka shtënë në drejtim të tyre “ *F. me ka godit me qyk te sëpatës në krah dhe unë e kam marr armen AK-47 kallash që ishte nën ulësen e veturës, dhe kur kanë tentuar që të më sulmojnë për së dyti, unë kam gjuajt me automat në drejtim të tyre dhe e kam qëlluar V., e kam rrok në këmbë dhe është rrezuar në tokë*”, për të vazhduar me tutje “ *krejt kjo ka ardhur pasi me herët H. – agja im është rrah me B. para 4 viteve*”.¹⁰

I akuzuari me tutje në mbrojtjen e tij ka deklaruar “ *se pushkën automatike e kam vendos vet nën ulësen e veturës, kur jemi nis me qu B. te mjeku, unë e kam lan automat nën karrigen e parë të veturës*”,¹¹

Trupi gjykues, pasi vlerësoi të gjitha këto prova të ndërlidhura njëra me tjetrën, konstatoi gjendjen faktike sa u përket veprimeve të të akuzuarit M. N në momentin e ngjarjes kritike, duke nxjerr një përfundim edhe logjik (sepse i akuzuari M.N është vëlla i B.Nt te cilin një ditë para ngjarjes kritike e kishin rrahur të dëmtuarit V. e F. V.,duke i shkaktuar lëndime në kokë), dhe një përfundim dhe konstatim po ashtu të gjendjes faktike të ndodhur në këtë ngjarje, me veprimet e të akuzuarit M.N dhe përfundimisht konstatoi se i akuzuari M.N me dashje direkte ka tentuar që ti privoj nga jeta tani të dëmtuarit V. e F. V., duke shtënë me pushkë automatike në drejtim të tyre, me ç’rast të dëmtuarin V. e qëllon me një predhë të shkrepur nga kjo armë dhe atë në kofshën e këmbës së djathtë, kurse i dëmtuari F. V. në ato

¹⁰ Pjese e mbrojtjes se te akuzuarit M.N e dhene ne shqyrtimin gjyqesor

¹¹ Po aty si ne fusnoten 10

momente largohet nga vendi i ngjarjes duke ikur me të shpejt dhe fshihet afër lokaleve të mobilierisë “.....”.

6.Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarit M. N dhe mbrojtësit të tij

Trupi gjykues, vlerësoi tezën e mbrojtësit të të akuzuarit M.N, avokatit Aziz Rexha, se i akuzuari në momentin e ngjarjes kritike, kur ka shtënë me pushkë automatike, në drejtim të të dëmtuarve V. e F., ka vepruar në suaza të mbrojtjes së nevojshme, duke u gjendur i sulmuar nga të dëmtuarit, e që këtë situatë dhe këtë mbrojtje, trupi gjykues e vlerësoi si të pazuar, meqë nga të gjitha provat u vërtetua e kundërta, pra dashja e të akuzuarit për kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë në tentativë, kjo për këto arsye:

Se pari, i akuzuari M.N ka deklaruar se i dëmtuari F. e ka goditë me qykë të sëpatës në krahë, pra ka ndodhur rrahja, ndërkaq i akuzuari e ka marr nga vetura pushkën automatike e që logjikisht do të ishte e pakapshme dhe faktikisht i pasqaruar fakti se për çfarë arsye të dëmtuarit nuk “ vazhduan”, sulmin ndaj tij, duke i dhënë kështu të akuzuarit M.N, mundësi dhe kohë që të shkoj deri te vetura që ishte rreth 3-4 metra larg, ta merr armën , e pasta sipas versionit të mbrojtjes dhe të akuzuarit, kur të dëmtuarit tentojnë ta sulmojnë për herën e dytë, i akuzuari nga një distancë po ashtu prej rreth 3 – 4 metra hap zjarr në drejtim të tyre.

Së dyti edhe po të ekzistonte kjo situatë (që rrahja në mes të palëve të konfrontuara nuk është përjashtuar), shtrohen shume dilema. Si, a ka mundur i akuzuari të largohet – kur veç deklaron vet se ka shkuar në veturë, kurse të dëmtuarit nuk janë vërsulur në drejtim të tij deri sa i akuzuari në dorë nuk kishte armën , që për të dëmtuarit do të ishte më lehtë që ta vazhdojnë sulmin me mjetet që i kishin në dorë.

Dhe së fundi, që i akuzuari nuk ka vepruar në suaza të mbrojtjes së nevojshme, kur ka shtënë me pushkë automatike në drejtim të të dëmtuarve kur nuk ishte i sulmuar nga të dëmtuarit “ kur kanë tentuar që të më sulmojnë për se dyti, unë kam gjujt.....”, ndërkaq, nuk është vërtetuar se në çfarë mënyrë kanë tentuar ta sulmojnë, intensitetin e sulmit e që këto të gjitha kanë mbetur dhe janë vlerësuar nga trupi gjykues vetëm si mbrojtje e “ supozuar”, meqë me të gjitha provat është vërtetuar ndryshe, situata e ndodhur dhe veprimet e qëllimshme të të akuzuarit M.N, për kryerjen e kësaj vepre penale , e që janë arsyetuar në pjesën e parë të vlerësimit të provave dhe si vlerësim përfundimtar i trupit gjykues, është pra se në veprimet e të akuzuarit M.N ekzistojnë të gjitha tiparet dhe elementet e veprës penale të vrasjes së rëndë në tentative si është cekur në dispozitiv të aktgjykimit.

Meqë, prokurori në aktakuzën e ndryshuar në shqyrtimin gjyqësor të datës 3 tetor 2013 të akuzuarit H.N dhe E.N.2 i akuzuar për veprën penale vrasja e rëndë në tentativë nga neni 147 par 1 nen par 9 në bashkëkryerje lidhur me nenin 23 të KPK-së, në atë mënyrë që në datën, kohën dhe vendin e cekur si në pikën I të dispozitivit të aktakuzës, të akuzuarit zbresin

nga një veture e paidentifikuar dhe sapo fillon rrahja ne mes të të akuzuarit M.N, E.N.1, H.N dhe E.N.2 ne njëren anë dhe te dëmtuarve V. e F. V. ne anën tjetër, te akuzuarit H.N e E.N.2 me armë të llojit të panjohur si dhe i akuzuari M.N , gjuajnë ne drejtim të të dëmtuarve, e qe i akuzuari M.N me një predhë e qëllon të dëmtuarin V., dhe me këtë ne bashkëkryerje kryen veprën penale te vrasjes së rende ne tentativë.

Trupi gjykues, me një kujdes profesional dhe bazuar ne dispozitat ligjore, shqyrtoi dhe vlerësoi te gjitha provat ne tërësi, ne kompleksitetin e rrethanave te ngjarjes kritike, përgjithësisht duke nxjerrë dhe identifikuar nga këto, veprimet konkrete të të akuzuarve H.N e E.N.2, dhe me këto duke konstatuar po ashtu gjendjen faktike te ndodhur ne rastin konkret, sa u përket veprimeve inkriminuese të të akuzuarve H.N dhe E.N.2.

Analizoi, po ashtu dëshmitë e dëshmitarëve V. e F. ne tërësi dhe ne drejtim të këtyre te akuzuarve, vlerësoi mbrojtjet e të akuzuarve, provat materiale dhe duke çmuar te gjitha këto prova ne një ndërlidhje njëra me tjetrën erdhi deri te përfundimi konkret i cekur si ne dispozitiv te aktakuzës qe kanë të bëjnë me te akuzuari H.N dhe E.N.2.

Trupi gjykues, nuk ka gjetur ndonjë prove konkrete që të akuzuarit H.N e E.N.2 do ti inkriminonte për kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë në tentative siç akuzohen me akuzën e ndryshuar.

Ne fakt, involvimi i tyre në ngjarjen kritike është provuar, por veprimet e tyre trupi gjykues i vlerësoi si veprime jo të drejtuara në kryerjen e veprës penale të vrasjes se rëndë në tentative dhe në bashkëkryerje edhe me të akuzuarin M. N.

Të gjitha provat e shtjelluara vërtetojnë këtë fakt, edhe përkundër dëshmime të dëshmitarëve V. e F. të dhëna gjatë fazave të procedurës penale dhe ne shqyrtimin gjyqësor, të cilët deklarojnë se në ngjarjen kritike kanë marr pjesë edhe të akuzuarit H.N dhe E.N.2, dhe kanë ndërmarr veprime konkrete secili “ *E.N.2i ka pas automatik dhe H. ka pas automatik dhe pasi qe unë jam rrezuar ne tokë, është afruar H. dhe me ka goditur me kondak te automatit, si kanë dal nga vetura, fillimisht ka gjujt E.N.2i me kallash duke me godit ne ekstremitetet e poshtme – me ka plagosur ne këmbën e djathtë*” ka deklaruar dëshmitari V. V. para prokurorit ¹², dëshmitari pastaj në shqyrtimin gjyqësor rreth këtij fakti deklaroi “*prej veture kanë dal..., E.N.2i ka pas kallash ne dorë, H. ka ardh prej mrapa veture po ashtu me kallash në dorë por nuk ka gjujt dhe nuk më ka qëlluar me kondak te armës*”,¹³

¹² Pjese e deklarates se dëshmitarit V.V dhene ne PPQ ne Prishtine me 04.08.2010

¹³ Pjese nga deklarimi i dëshmitarit V. V ne shqyrtimin gjyqësor te dates 15.04.2013

Edhe dëshmitari F. V. në deklaratimet e tij të dhëna gjatë fazave të procedurës penale, i ka involvuar të akuzuarit H.N dhe E.N.2 në ngjarjen kritike “ fillimisht E.N.1i e H. e kanë gjuajt babën tim, E.N.2i e ka gjujt V.in, kurse mua me kanë gjuajt Sh.a, B. e M.”,¹⁴ për të vazhduar në shqyrtimin gjyqësor “ H. N e ka gjujt babën tim me kallash, e ka rrok dhe i njëjti ka ra ne tokë, kurse E.N.2 me ka gjujt mue me kallash ne kemben e majte”.

Pasi i vlerësoi këto deklaratave të dëshmitarëve, trupi gjykues fitoi një përshtypje dhe bindje se kemi të bëjmë me deklarime të dëshmitarëve të frustruar nga pasojat e ngjarjes dhe emocionet e tyre të krijuara nga ngjarja, si dhe ekzagjerim të veprimeve të të akuzuarve H.N dhe E.N.2, pra disharmonia e secilit dëshmitar, në dhënien e deklaratave është e madhe si me vetveten – pra në mes të deklaratave të dhëna nëpër faza të procedurës, ashtu edhe në mes të deklaratave të këtyre dëshmitarëve, por prap trupi gjykues këto dëshmi duke i ndërlidhur me prova të tjera nga ndërlíkueshmeria e ngjarjes së krijuar ditën kritike, nxori përfundimin për gjendjen faktike sa u përket veprimeve të këtyre të akuzuarve. Kjo nga fakti se në vendin e ngjarjes janë gjetur dy lloje të gëzhgojave të armeve, me rastin e vëzhgimit të vendit të ngjarjes dhe atë dy gëzhgoja të armës së shkurtë – revole dhe dy gëzhgoja të armës së gjatë – pushke automatike si dhe janë sekuestruar po ashtu dy armë që njëra ka qenë revole dhe tjetra pushkë automatike.

Gjatë ekzaminimit balistik të armeve të sekuestruara, është konstatuar se dy gëzhgoja të ekzaminuara të armës së gjatë si dëshmi D#7 dhe D#8 – pjesë të fishekëve të kalibrit 7.62x39 mm, janë të gjuajtura nga pushka automatike AK-47 me numër serik kal 7.62x39 mm.¹⁵

Me rastin e vëzhgimit të vendit të ngjarjes nga ana e policisë, nuk janë gjetur gëzhgoja të tjera apo të kalibrave të armëve të tjera, pra nuk janë sekuestruar armë të tjera lidhur me ngjarjen apo të involvuara në këtë rast, përpos atyre që u cekën më lartë, andaj si përfundim është se në rastin tragjik janë përdorur dy lloje të armeve nga të akuzuarit E.N.1 e M. N.

Kur, këtyre provave materiale u shtohen edhe dëshmitë e dëshmitarëve V. e F.(me vlerësimet e dhëna të trupit gjykues për këto dëshmi), në drejtim të të akuzuarve H.N e E.N.2, konstatimi përfundimtar i trupit gjykues është se në veprimet e të akuzuarve H.N dhe E.N.2 nuk ka elemente të veprës penale vrasja e rëndë në tentativë dhe bashkëkryerje siç akuzohen me aktakuzën e ndryshuar të prokurorit.

P

Andaj trupi gjykues në këtë drejtim duke pas parasysh obligimin ligjor që aktgjykimin ta bazoj në provat dhe faktet e proceduara në shqyrtimin gjyqësor, pra në materialet që janë grumbulluar gjatë fazave të procedurës penale, me zbatimin e dispozitave ligjore, e në këtë

¹⁴ Pjesë e deklaratimit të dëshmitarit F.V në PPQ në Prishtinë me 06.08.2010

¹⁵ Raporti i ekspertizës së armeve 20100518 të datës 01.11.2010

drejtim të provave të mbledhura me rastin e vëzhgimit të vendit të ngjarjes – sa i përket armëve të përdorura ne ngjarjen kritike, në ndërlidhje me dëshmitë dhe faktet e tjera si plagosjes së të dëmtuarit V., gjetjes te vetëm dy gëzhjojave të armës automatike që i kanë takuar të njëjtës armë të sekuestruar, përdorimin e armeve të tjera në këtë ngjarje e vlerësoi si të “supozuar” me arsyet e dhëna më lartë.

Po ashtu trupi gjykues duke vlerësuar se aktgjykimi dhe sanksioni penal ndaj të akuzuarve, duhet të mbështetet në gjendjen faktike të sigurte dhe të vërtetuar, që në rastin konkret nuk janë gjetur armë të tjera dhe nuk është vërtetuar shkrepja e predhave të tjera, përpos atyre që janë konstatuar, andaj fakti i tillë nuk ka mundur të vërtetohet nga gjykata me bindshmeri të plotë dhe përtej standardit të dyshimit të bazuar, e që mëdyshjen lidhur me këtë fakt të çështjes e interpretoi në favor të të akuzuarve mbi bazën e parimit ligjor *in dubio pro re*, meqë faktet e rëndësishme trupi gjykues nuk ka mundur ti vërtetoj me bindshmëri të plotë , andaj kjo mëdyshje u interpretua ne favor të të akuzuarve.

Duke vlerësuar ngjarjen e ditës kritike në tërësi, ndërlidhur me provat e çështjes penale, trupi gjykues ka gjetur se në veprimet e të akuzuarve H.N dhe E.N.2 ekzistojnë elementet e veprës penale pjesëmarrja në rrahje me pasojë vdekjen nga neni 155 par 1 te KPK-së.

Pjesëmarrja e të akuzuarve H.N e E.N.2, në ngjarjen kritike edhe pse është mohuar nga të akuzuarit, është vërtetuar nga dëshmitarët V. e F., të cilët në të gjitha fazat e procedurës penale me deklaratimet e tyre kanë dëshmuar se të akuzuarit kanë marr pjesë në ngjarjen e ditës kritike, duke theksuar veprimet e secilit, por që deklaratimet e tilla për veprimet inkriminuese të të akuzuarve trupi gjykues i vlerësoi në pjesën e vlerësimit të dëshmimeve të dëshmitarëve.

Se ditën kritike, ngjarjes i ka paraprirë rrahja në mes të akuzuarit M.N në njërën anë dhe të dëmtuarve V. e F. në anën tjetër, kjo është vërtetuar nga dëshmitari F. në dëshminë e tij të dhënë në procedurë paraprake “ *ata jan nis ne drejtim tonin dhe ka filluar rrahja ne mes neve dhe atyre, M. me ka godit ne kokë m e diqka- hekur, a dru nuk e di, une kam tentu me godit M.n me sopat, po nuk e di a e kam godit*”¹⁶

E pastaj dëshmitari, prap skjaron se “ *une e kam marr sopaten nga stresi kam tentu qe ti sulmoj ata*”¹⁷.

Edhe në shqyrtimin gjyqësor dëshmitari pjesërisht konfirmon rrahjen qe ka ndodhur ditën kritike “*kur ka dal M. prej veturës ka pas diqka ne dore, por nuk e ka përdor, une e kam pas sopaten ne dorë por nuk e kam përdor fare*”.

¹⁶ Pjese e deklarates te deshmitarit F.V e dhënë ne procedure paraprake me date 18.02.2010,

¹⁷ Pjese e deklarates se deshmitarit F. Vi e dhene ne PPQ me date 06.08.2010,

Dëshmitari V. V. në çdo deklaram të tij gjatë fazave të procedurës penale ka konfirmuar se ditën kritike ka ndodhur rrahja në mes të tij dhe vëllait F. në një të anë dhe të akuzuarit M.N me pjesëmarrjen e të akuzuarve H.N dhe E.N.2 në anën tjetër “*qe te dy me kan goditur, njeri me kondak te armës ndërsa M. me shkop dhe me kan rrezuar skaj rruge*”, deklarimi i parë i dëshmitarit në polici me 03.03.2010, që pastaj për këtë çështje në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se H. e ka ndjekur duke e mbajtur në dorë armën – kallashin por nuk e ka gjuajtur me këtë armë.

I akuzuari M. N, po ashtu ka deklaruar në mbrojtjen e tij, se ditën kritike pasi kanë dal nga veturat, djali i B. e ka goditur me sëpatë që në shqyrtimin gjyqësor po ashtu ka deklaruar se është sulmuar nga V e F. e që ky i fundit e ka goditur me sëpatë duke i shkaktuar lëndime trupore.

7. Vleresimi i veprimeve të të akuzuarve H.N dhe E.N.2

Nga të gjitha provat e shqyrtuara, trupi gjykues konstatoi se në veprimet e të akuzuarve H.N e E.N.2 ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale pjesëmarrja në rrahje në të cilën si pasojë ka humbur jetën tani i ndjeri B.V.

Rrahje konsiderohet çdo konflikt fizik në mes të dy ose më shumë personave – që në rastin konkret është vërtetuar se në momentin kritik në rrahje kanë marr pjesë të dëmtuarit V. e F. dhe në anën tjetër të akuzuarit M.N, H.N dhe E.N.2.

Si kusht tjetër është që gjatë rrahjes të privohet nga jeta e që paraqitet si *condicio sine qua non*, si kusht primar, e që është konstatuar me të gjitha provat se në rastin konkret ka ndodhur rrahja me pasojë vdekjen- është privuar nga jeta tani i ndjeri B.V.

Në rrahje konsiderohet se merr pjesë çdo person i cili gjendet në vendin e ngjarjes kur ndodh rrahja dhe që merr pjesë në rrahje me veprime aktive , fizike apo psikike, që në rastin konkret trupi gjykues ka konstatuar se i akuzuari H.N dhe E.N.2 me veprimet e tyre aktive kanë marr pjesë në rrahje, duke u vërsulur në drejtim të të dëmtuarve “*H. me ka ndjek me kallash ne dore*”, deklaroi i dëmtuari F., dhe i akuzuari E.N.2 po ashtu me pjesëmarrje aktive psikike “*vraje qenin*”, duke aluduar në të dëmtuarin V. V..

Prania dhe pjesëmarrja e të akuzuarve H.N dhe E.N.2 në rrahjen e ditës kritike pa dyshim ka sjellë me veprimet e tyre direkt ose indirekt pasojën e rëndë (ka humbur jetën tani i ndjeri B.V).

Te akuzuarit H.N dhe E.N.2, veprën penale të pjesëmarrjes në rrahje e kanë kryer me paramendim – shkuarja në vendin e ngjarjes, duke marr pjesë në rrahje në të cilin ngjarje të akuzuarit E.N.1 e M.N kishin armë të cilat edhe i kanë përdor, që këto fakte nënkuptojnë

edhe vetëdijen e tyre për mundësinë e shkaktimit të vdekjes së ndonjë personi – gjë që edhe ka ndodhur pasojë e rëndë, pra vrasja e të ndjerit B.V dhe plagosja e të dëmtuarit V. V..

Trupi gjykues, ka vërtetuar motivin e të akuzuarit E.N.1 për kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë në ngjarjen kritike, të vrasjes së rëndë në tentativë nga i akuzuari M. N dhe të pjesëmarrjes në rrahje me pasojë vdekjen nga të akuzuarit H.N dhe E.N.2.

Pas vlerësimit të përgjithshëm të rrethanave të ngjarjes kritike dhe të rrethanave para ngjarjes së tillë u konstatuar se të akuzuarit dhe të dëmtuarit kishin raporte jo të mira dhe të acaruar që kanë filluar si kontest rreth një mali në fshatin Burrnik, Komuna Ferizaj, me ç'rast janë përleshur fizikisht i akuzuari H.N me të ndjerin B.V dhe djalin e tij F.in, disa vite para se të ndodhë ngjarja kritike, kanë ndërmjetësuar njerëz te ndryshëm dhe këshilla te pajtimit për ti afruar raportet e tyre por nuk kishin sukses.

Që raportet janë acaruar edhe me tepër, kur me datën 17.02.2010, në Ferizaj të dëmtuarit V. e F. e kanë rrahur B.N (djale vëllai i të akuzuarve E.N.1, H.N dhe E.N.2 dhe vëlla i të akuzuarit M.N), në atë mënyrë që i kanë shkaktuar lëndime në kokë.

Ekzistimi i raporteve të tilla në mes të këtyre dy familjeve – pra edhe në mes të akuzuarve dhe të dëmtuarve, është konfirmuar në çdo fazë të procedurës , si nga të akuzuarit ashtu edhe nga të dëmtuarit, edhe pse të akuzuarit, e në veçanti i akuzuari E.N.1 ka deklaruar se ditën kritike, me veturën e tij ka qenë duke e dërguar te mjeku djalin e vëllait B. dhe rrugën ua ka zënë tani i ndjeri B. me djemtë e tij dhe kur ka kuptuar se aty është prezent i akuzuari E.N.1 i ka thënë se me këtë nuk ka punë.

I akuzuari M.N, ka deklaruar se pushkën automatike e ka vendos në veturë para se të nisen për në Ferizaj ku kishin për ta dërguar vëllain e tij B. te mjeku, dhe se deri të ngjarja kritike sipas këtij te akuzuari ka ardhur ngase raportet me familjen e të dëmtuarve i kishin te acaruar, nga fakti se agja i tij H. është rrahur me tani të ndjerin B..

Trupi gjykues nga të gjitha këto gjeti se të akuzuarit, veprat penale i kanë kryer nga motivi i hakmarrjes së paskrupullt ndaj të ndjerit B.V dhe djemve të tij V. e F. V..

Gjatë zhvillimit të shqyrtimeve gjyqësore dhe procedurës së provave, trupi gjykues ka pasur parasysh çdo provë që ishte e rëndësishme për zbardhjen dhe gjetjen e së vërtetës në këtë çështje penale, andaj edhe në këtë kuptim ka refuzuar me aktvendime procedurale propozimet e palëve në procedurë për nxjerrjen e disa provave të reja duke patur bindje të plotë se çështja penale ne vija te përgjithshme ishte e njohur për trupin gjykues, apo provat e tilla të propozuara ishin të pa ndikim ne gjendjen faktike e disa të tjera të pa përshtatshme.

7. Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarve H.N dhe E.N.2 dhe e mbrojtësve të tyre

Mbrojtja e të akuzuarve H.N dhe E.N.2 të dhënë në shqyrtimin gjyqësor nga trupi gjykues është vlerësuar si mbrojtje e tillë me të cilën të akuzuarit kanë pas për qellim shmangien nga përgjegjësia penale, kur kanë deklaruar se në ngjarjen e ditës kritike nuk kanë marr pjesë fare në këtë ngjarje, me arsyetimet dhe alibinë që i kanë cekur në mbrojtjet e tyre.

Prania e të akuzuarve në vendin e ngjarjes dhe involvimi i tyre me veprimet konkrete është sqaruar gjatë shqyrtimeve gjyqësore me të gjitha provat e që trupi gjykues i ka vlerësuar në pjesën e vlerësimit të provave, dëshmive dhe veprimeve të të akuzuarve.

Në këtë kuptim edhe pretendimet e mbrojtësve të të akuzuarve H.N dhe E.N.2 avokateve Bahtir Troshupa e Muhamet Beqiri, se të akuzuarit nuk kanë qenë fare në vendin e ngjarjes të ditës kritike, nga ana e trupit gjykues u vlerësuan si të pa baza dhe të pa mbështetura në asnjë provë, ngase involvimi i tyre me veprimet konkrete në ngjarjen kritike u vërtetuar bindshëm me të gjitha provat të cilat trupi gjykues i arsyetojë në pjesët e këtij aktgjykimi.

8 Vlerësimi ligjor i veprimeve të të akuzuarve E.N.1, M.N, H.N dhe E.N.2

Trupi gjykues konstatoi se në veprimet e të akuzuarit E.N.1., ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale vrasja e rëndë nga neni 147 par 1 nën par 9 dhe të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 paragraf 2 të KPK-së, se i akuzuari me dashje direkte nga hakmarrja e paskrupullt ka vepruar për të realizuar pasojën – vrasjen e tani të ndjerit B.V, ashtu që qëllimi mendor kriminal *mens rea*, del qartazi, marrja e armës – revolës, nisja për të shkuar në Ferizaj dhe me të vërejtur veturën e të dëmtuarve ua bllokoi rrugën me veturën e tij, duke realizuar kështu elementin *actus reus*, shkuarjen në vendin e ngjarjes i armatosur, bashk me të akuzuarit e tjerë, prej të cilëve po ashtu i akuzuari M.N i armatosur me pushkë automatike.

Në përgjithësi të vrasjet e rënda – të kualifikuara shprehet një shkallë më e lartë e kundërligjshmërisë dhe e fajësisë së kryesit, që në rastin konkret lidhur me motivin e të akuzuarit për të kryer vrasjen nga hakmarrja e paskrupullt, e që motivi i të akuzuarit ka tejkaluar hakmarrjen e thjeshtë – rrahjen e B.N nga të dëmtuarit V. e F. V., duke vepruar në mënyrë të paskrupullt, duke vrarë tani të ndjerin B.V për shkak të së keqes të pësuar me parë nga i ndjeri dhe djemtë e tij.

Për të akuzuarin M. N, u konstatua se në veprimet e tij janë formësuar të gjitha tiparet objektive e subjektive të veprës penale, vrasja e rëndë në tentativë nga neni 147 par 1 nën par

9 dhe të veprës penale mbajtja ne pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim te paautorizuar te armeve nga neni 328 parag 2 te KPK-së.

Vendosja e pushkës automatike në veturë nga i akuzuari M.N, para nisjes për në Ferizaj, tregon haptas qëllimin kriminal për të kryer veprat penale, me qëllim dhe dashje për të realizuar pasojën e shkaktuar, për motivet e hakmarrjes së paskrupullt.

Edhe në veprimet e të akuzuarve H.N dhe E.N.2, trupi gjykues konstatoi se ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale pjesëmarrja në rrahje, kjo, ngase të njëjtit në vendin e ngjarjes kanë shkuar bashkë me të akuzuarit E.N.1 e M.N, kanë marr pjesë aktive në rrahje goftë fizikisht apo në formë psikike, e që në atë rrahje një person e ka humbur jetën.

9. Përcaktimi i dënimit

Trupi gjykues, me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësive të dënimeve për të akuzuarit, pati parasysh të gjitha rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit të parapara në nenin 64 te KPK-së.

Si rrethana lehtësuese për të gjithë të akuzuarit pati parasysh faktin se nuk ka evidencë që më parë të kenë kryer vepra penale, që si rrethanë e tillë paraqet rrethanë minore krahasuar me rrethanat renduese të cilat gjykata i gjeti në rastin konkret për të gjithë të akuzuarit e që janë: veprimet e të akuzuarve në veçanti te akuzuarit E.N.1 e M.N, paraqesin shkallë të lartë të rrezikshmërisë shoqërore dhe intensitet i lartë i rrezikimit dhe dëmtimit të vlerës së mbrojtur – jetën e njerëzve , rrethanat në të cilat është kryer vepra penale e vrasjes së rëndë dhe e vrasjes rëndë në tentativë, mënyra e kryerjes së veprave penale – duke vepruar në grup, në rrugë dhe në vend publik, duke vepruar me agresivitet dhe vendosmëri të një shkalle të lartë, mjetet e përdorura- armët e zjarrit dhe shkrepja nga revolja dhe nga pushka automatike si armë e rrezikshme dhe shtënia me këto armë në afërsi, përgatitjet paraprake të të akuzuarve – duke i vendosur në veturë armët e zjarrit për ti përdorur pastaj për kryerjen e veprave penale.

Ndërkaq sa u përket veprave penale të mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim te paautorizuar te armeve nga neni 328 parag 2 të KPK-së, gjykata pati parasysh faktin se me këto armë është kryer vepra penale e vrasjes së rëndë dhe e vrasjes së rëndë në tentativë.

Trupi gjykues mbi bazën e këtyre rrethanave të akuzuarit E.N.1 i shqiptoi dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 19 (nëntëmbëdhjetë) vite, të akuzuarit M. N dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 11 (njëmbëdhjetë) vite, kurse të akuzuarve H.N e E.N.2 dënim burgimi në kohëzgjatje prej nga 1(një) vit, me bindje se dënimet e shqiptuara janë ne harmoni me peshën

e veprave penale, shkallen e përgjegjësisë penale të të akuzuarve, se me dënimet e shqiptuara do arrihet qëllimi nga neni 34 i KPK-së, që të parandaloj të akuzuarit në të ardhmen të mos kryej vepra penale (preventiva speciale) dhe duke i parandaluar personat e tjerë në kryerjen e veprave të tilla të rrezikshme, pra do t'i shërbej preventives gjenerale.

10. Llogaritja e paraburgimit, konfiskimi, shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesa pasurore juridike

Në dënimet e shqiptuara të akuzuarve E.N.1, M.N e H.N Nu është llogaritur koha e kaluar ne paraburgim siç parashihet ne nenin 73 par 1 të KPK-së.

Me aplikimin e nenit 367 par 1 nen par 1.2 të KPPK-së, me aktvendim të veçantë u është vazhduar paraburgimi të akuzuarve E.N.1 dhe M. N, kurse të akuzuarit H. N i është ndërprerë paraburgimi bazuar në nenin 393 par 2 nen par 5 të KPPK-së, meqë për shkak të llogaritjes së paraburgimit në dënimin e shqiptuar, i njëjti e ka vuajtur dënimin.

Në bazë të nenit 328 par 5 te KPK-se, konfiskohen armët e përdorura për kryerjen e veprës penale dhe atë 1(një) revole e tipit “” e modelit M-57 të kalibrit 7.62x25 mm, me nr. serik H-103489,1 karikator për këtë revole , si dhe 14 fishekë të kalibrit 7.62x25mm si dhe një pushkë automatike e tipit AK-47 e modelit kinez type – 56 , kalibrit 7.62 mmx39 mm, me numër serik, një karikator për këtë pushke automatike.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 99 e 102 të KPPK-se, që kap shumën prej 400 euro për paushallin gjyqësor duke pasur parasysh komplikueshmerine e procedurës penale dhe gjendjen ekonomike të të akuzuarve si dhe shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 81.76 euro.

Gjykata, familjen e tani të ndjerit B.V dhe atë: bashkëshorten M. V. si dhe të dëmtuarit V. e F. V., për realizimin e kërkesës pasurore juridike në tërësi i udhëzoi në kontest civil në kuptim të nenit 112 par 2 të KPK-së, sepse të dhënat e mbledhura në procedure penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë apo të pjeserishem te kërkesës pasurore juridike.

Nga të cekurat me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR 6/2013
Me, 3 tetor 2013

Sekretarja juridike
Qëndresa Bobi

Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari,
IBRAHIM IDRIZI

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të kopjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.